



Së bashku mund t'ia dalim



Projekti:

**“Të rritet përkushtimi i komunitetit rom dhe egjiptian
për t'u dhënë zë nevojave të tyre.”**

“Të rritet përkushtimi i komunitetit rom dhe egjiptian për t'u dhënë zë nevojave të tyre.” – Projekt i Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin në bashkëpunim me shoqatat: Instituti i Kulturës Rome, Bashkimi Demokratik i Romëve, si dhe Një zë i barabartë rom e egjiptian në komunitetin vlonjat.

Gusht-tetor 2016

Prezantimi i projektit.

2

“Të diskutojmë së bashku për shqetësimet tona.”

4

“Të ndërtohet vizionin e komunitetit.”

8

Pjesë nga ligji “Për Vetëqeverisjen Vendore.”

10



Projekti: “Të rritet përkushtimi i komunitetit rom dhe egjiptian për t'u dhënë zë nevojave të tyre”

Qytetaria është zemra e funksionimit të demokracisë. Qytetarët i japin jetë dhe kuptim parimeve dhe institucioneve. Pa pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën politike, fuqia e qeverisë mund të jetë abuzive dhe të drejtat themelore dhe liritë e demokracisë, nuk mund të realizohen. Një demokraci e suksesshme kërkon qytetarë të informuar, qytetarë, që kuptojnë idetë rreth qytetarisë, politikës dhe qeverisë.

Në muajin gusht të vitit 2016, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin në bashkëpunim me shoqatat: Instituti i Kulturës Rome, Bashkimi Demokratik i Romëve dhe Një zë i barabartë rom e egjiptian në komunitetin vlonjat, mbështetur

nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka nisur zbatimin e një projekti për të rritur pjesëmarrjen e informuar të qytetarëve romë dhe egjiptianë në proceset politike dhe për të ndihmuar në krijimin e një kulture pjesëmarrjeje të këta qytetarë.

Ky projekt po zbatohet në periudhën gusht 2016—mars 2017. Deri tani veprimtarët romë kanë organizuar takime të mirëstrukturuara me bashkëqytetarët e tyre, duke rrahur mendimet, lidhur me çështjet më shqetësuese, që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme nga pushteti vendor, apo ai qendror. Në muajin tetor, janë zhvilluar dy kurse trajnimi: në Tiranë dhe në Vlorë me përfaqësues nga komuniteti rom dhe egjiptian lidhur me “Avokatësinë dhe organizimin e komunitetit”.

Në muajt nëntor-dhjetor do të zhvillohen takime me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit rom dhe egjiptian, Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të kërkuar mbështetjen e këtyre institucioneve në këto përpjekje qytetare.

Në prag të hartimit të projektbuxhetit qendror, në muajin mars, do të organizohen takime publike me përfaqësues të qeverisjes

vendore apo/dhe qendrore. Në këto takime banorët romë dhe egjiptianë nga zonat e projektit do të ballafaqojnë të zgjedhurit dhe zyrtarët me shqetësimet e tyre dhe do të kërkojnë nga ata që këto përparësi t'i bëjnë pjesë të planeve të punës për vitin 2017. “Në këtë trajnim mësova se demokraci nuk do të thotë thjesht të japësh votën, por do të thotë të marrësh pjesë - Sanija Shkozë”.

Mediat lokale dhe kombëtare do të ftohen të filmojnë këto veprimtaripër t'i bërë jehonë kësaj nisme dhe për të shtuar radhët e mbështetësve.

Historitë e suksesit të këtij projekti do të pasqyrohen përmes kësaj reviste, që do të shpërndahet gjatë veprimtarive të projektit. Një shfaqje teatrore do të përcjellë te komuniteti mesazhe të mosdiskriminimit të popullatës romë dhe egjiptiane për arsye të përkatësisë etnike dhe thirrje të politikëbërësit për ndërhyrje të menjëhershme për përmirësimin e situatës së këtyre komuniteteve. Në të njëjtën kohë përmes rrjeteve sociale, thirrjeve të drejtpërdrejta do të inkurajohen qytetarët romë e egjiptianë t'u bashkohen radhëve të veprimtarëve.

Të tëra këto ndërhyrje pritet të krijojnë disa praktika të mira të angazhimit të qytetarëve romë dhe egjiptianë për përmirësimin e jetesës dhe të aktivizimit të tyre të mëtejshëm edhe pas përfundimit të projektit.

**“Në këtë trajnim
mësova se demokraci
nuk do të thotë
thjesht të japësh
votën, por do të thotë
të marrësh pjesë”**

- Sanija, Shkozë

Të diskutojmë së bashku për shqetësimet tona

Në muajt gusht-shtator banorët romë dhe egjiptianë të Shkozës, Bregut të Lumit, Siri Kodrës dhe Novoselës u mbledhën së bashku në komunitetet e tyre dhe diskutuan rreth shqetësimeve që këto komunitete kanë. Pas rrahjes së mendimeve, çështjet që u listuan ishin: strehimi, politika lehtësuese për punësimin dhe shkollimin e këtyre komuniteteve, riparimi i rrugëve, përmirësimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha, sigurimi i ujit të pijshëm, ndalimi i djegies së mbeturinave pranë zonave të banuara, ndriçimi, legalizimet e banesave, etj. Në të vërtetë një mori çështjesh dhe shqetësimesh u përcollën nga pjesëmarrësit në këto takime, si një dëshmi e përforcuar për të treguar se sa shumë punë nevojitet nga pushteti vendor dhe vetë banorët që kjo situatë të ndryshojë.

Në konkluzion të diskutimeve pjesëmarrësit ranë dakord për dy çështje më parësore, që do të diskutohen në takimet me të zgjedhurit vendorë apo qendrorë, të cilat janë:

- **Komuniteti rom dhe egjiptian i Shkozës: politika lehtësuese për strehimin dhe punësimin e komunitetit rom dhe egjiptian.**
- **Komuniteti rom dhe egjiptian i Siri Kodrës dhe i Bregut të Lumit: përmirësimi i infrastrukturës lokale rrugët dhe uji i pijshëm.**
- **Komuniteti rom dhe egjiptian i Novoselës: politika lehtësuese për strehimin dhe rregullimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha.**
- **Komuniteti rom dhe egjiptian i Vlorës: politika lehtësuese për strehimin dhe për të shmangur braktisjen e shkollës nga fëmijët romë.**



Më tej veprimtarët e këtyre komuniteteve mblodhën informacion më të detajuar nga banorët e lagjeve, si edhe pranë zyrave përkatëse të njësive të qeverisjes vendore dhe hartuan një panoramë të plotë të situatës aktuale të lidhur me këto çështje që e përfshinë në një dokument të quajtur “Platforma e komunitetit”. Kjo platformë do të shërbejë si material referimi në të gjitha takimet, që do të organizohen në vijim për përfshirjen e këtyre përparësive në projektbuxhetin vendor.



Të ndërtosh vizionin e komunitetit

Në muajin tetor 2016, 40 pjesëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian morën pjesë në dy trajnime (Tiranë dhe Vlorë) me temë: “Si të avokojmë për të drejtat tona”. Pjesëmarrësit u piketuan dhe u rekomanduan nga shoqatat lokale rome, partnerë të QSHPHZ-së në këtë projekt dhe projekte të mëparshme.

Temat e shtjelluara ishin: Struktura dhe funksionet e qeverisjes vendore Rëndësia e zgjedhjeve, Parimet e demokracisë, Organizimi i komunitetit, Avokatësia dhe mekanizmat e pjesëmarrjes. Moderatorët përdorën një gjuhë të përshtatshme dhe një sërë metodash ndërvepruese për të nxitur pjesëmarrjen si punë me grupe, prezantime, lojëra, etj.



Pjesëmarrësit shfaqën një interes të madh dhe ishin shumë aktivë gjatë diskutimeve duke dhënë mendime konstruktive për të gjitha temat.

Një çast, që i mbajti të gozhduar diskutantët ishte ndërtimi i vizionit të komunitetit, ku ata jetonin, si dhe hartimi i planeve të veprimit për përmirësimin e gjendjes aktuale. Ata punuan në grupe dhe hartuan hapat që do t'i çonin drejt zgjidhjes së

Shpresa nga Novosela u shpreh: “Vizioni për komunitetin tim më shtyn të përpiqem dhe të luftoj bashkë me banorët e tjerë që problemet dhe hallet tona të zgjidhen sa më parë”.

shqetësimeve të tyre si: takimet me përfaqësuesit e pushtetit, pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit, krijimi i një baze mbështetësishe, duke përfshirë edhe shoqërinë civile, bashkëpunimi dhe komunikimi me median, etj. Përfaqësues nga grupet e punës bënë prezantimet dhe ndanë vizionin e tyre për komunitetin edhe me të tjerët.

Kjo metodologji e ndërtimit të një vizioni për komunitetin ishte mjaft motivuese për pjesëmarrësit. Këta qytetarë pritet të jenë liderët e komunitetit, që do të udhëheqin veprimtaritë e tjera të projektit në zonat e tyre dhe do të organizojnë pjesën tjetër të komunitetit për t'u bërë pjesë e nismave qytetare të reja.




II.ORIGJINA DHE HISTORIA E ROMËVE

Në kujtim të Riza Lahit

Duke udhëtuar në tren me Dr.Prof. Marcel Kurtiadhin

Në vitin 2014, në nëntor, isha ftuar në kongresin botëror të romëve, që u zhvillua në Lanciano diku 350 kilometra në jug të kryeqytetit italian. Në po atë kongres merrte pjesë dhe Marcel Kurtiadihi, komisar i bashkimit kombëtar të romëve për gjuhën dhe të drejtat gjuhësore, por edhe ish punonjës i ambasadës franceze në Tiranë në kohën e komunizmit.

Marceli i saktë si një kompjuter biologjik dhe zemërbardhë si një fëmijë, ka jetuar në Shqipëri pa ndërprerje afro 16 vite. Ai ka themeluar që në vitin 1991 filialin "Romani baxt", një institucion parashkollor, që i përgatiste fëmijët romë të lagjes 10 në Tiranë, për t'u integruar më mirë në shkollën fillore e që i ndihmonte gjatë viteve të shkollës. Ai sot punon si profesor në një nga universitetet e Parisit në



Francë dhe është shef i Katedrës për gjuhën dhe Kulturën Rome. Marcel është një nga burrat me kujtesë fenomenale që kam mundur të takoj në jetën time. Marcel Kurtiadhit i pëlqeu shumë, kur në trenin e linjës së Romës, përpos disa pyetjeve gazetareske që i bëra fillimisht, nisa të mbaja shënime, ndërsa ai po me shpjegonte historinë e romëve.

–Po kalojmë tani pranë qytetit italian Forli, - tha ai. - Këtu në vitin 1422 erdhën romët e parë të njohur me dokumente në tokën italiane, e cila sot numëron rreth 1.000.000 (një milion) romë. Kjo vërtetohet edhe nga një pllakë përkujtimore e shkruar në latinisht, që ekziston edhe sot : “Më 2 gusht 1422, një grup prej 200 burrash dhe grash kaloi këtu duke shkuar drejt Romës që të takonin Papën e të merrnin fenë tonë. Thuhej se kishin udhëtuar që nga India”. Natyrisht që ata nuk e kanë pasur hallin të punët e fesë. Nuk kishin ardhur enkas që nga India e largët vetëm për t'u bërë katolikë pas takimit me Papën. Në fakt kishin ardhur nga Azia e Vogël – që është sot Turqia, bashkë me persianë nga Horosani (një krahinë e ndarë sot në Iran e Turkmeni) si edhe turq selçukë. Të gjithë bashkë konsideroheshin saraçenë nga të krishterët. Edhe më parë ka pasur ardhje romësh në Itali, më saktë në Venedik, si duket që nga shekulli i 13-të në kohën e marrëdhënieve tregtare midis Venedikut dhe sulltanatit sulçuk të Konjasë. Mirëpo këto shkëmbime nuk shiheshin mirë nga Roma dhe romët nuk janë mirëpritur, sidomos nga kisha, që predikonte akuzën, se ata nuk ishin tjetër, veçse spiunë të turqve...Kemi disa dëshmi të tjera për prejardhjen indiane të romëve, por njëra prej tyre është me interes të veçantë

(Vijon në numrin e ardhshëm..._

Riza Lahi

III. Të Njohim të Drejtat Tona

LIGJI41 Nr. 139/2015 PËR VETËQEVERISJEN VENDORE

KREU VI TRANSPARENCA, KONSULTIMI DHE PJESËMARRJA QYTETARE

Neni 15

Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.
2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.
3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

Neni 16

Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.
2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

Neni 17

Mbledhjet e këshillit të bashkisë

1. Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e të gjithë anëtarëve të tij.

Neni 19

E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes

1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje, që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.
2. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Neni 20

E drejta e nismës qytetare

1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në këshillin bashkiak nisma qytetare për çështje, që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre nismave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak.



Të gjithë ju qytetarë që doni të bashkoheni me ne në këtë nismë apo dëshironi të informoheni më tej, mund të na kontaktoni në adresat e mëposhtme:



Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin

Bulevardi: "Gjergj Fishta",

Kompleksi "Tirana 2000", Kulla VIII, Kati II, Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 (42) 251 475; Email: info@acpd-al.org




Qendra AULONA

L. "29 Nëntori", Përballë Bibliotekës së qytetit

Çerdhja 15, Kati II, Vlorë, Shqipëri

Telefon: +355 (33) 2 24531; Email: aulona.center@gmail.com

web: acpd.org.al



Embassy of the United States of America
Tirana, Albania

Ky material është pjesë e projektit që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A.-se në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit